

V E N D I M
I GJYQITARIT TE VETEM

Une gjyqtarja A. Kuoxhiq, gjyqetare e gjykates se rrethit Tirane, sot ne date 28.2.2001, pasi shqyrtova kerkesen e kerkuesit Erjon Zaloshnja, i cili kerkon te regjistrohet si person juridik

K O N S T A T O V A:

Se kerkuesi Erjon Zaloshnja kerkon te rregjistroje si person juridik shoqerine "ARTENATIVA" sh.p.k. me seli ne Tirane rruga Bardhok Biba, P. 75, sh. 3, ap. 55, me kohe zgjatje mbi 10 vjet me kapital themeltar 100.000(njeqin mije)lek, me ortak te vetem dhe administrator vete kerkuesin dhe me objekt:

- **Prodhime audio-vizive, sherbime dhe asistence teknike ndaj te treteve ne keto fusha.**

Kerkuesi ka derdhur kapitalin themeltar prej 100.000(njeqind mije)Lek ne Banken e Kursimeve Tirane.

Kerkesa e tij eshte e drejte dhe duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjes 7512 date 10.08.1991 dhe te ligjes 7638 date 19.11.1992

V E N D O S A

- Pranimin e kerkeses.
- Rregjistrimin si person juridik te shoqerise "ARTENATIVA" sh.p.k. me ortak te vetem dhe administrator Erjon Zaloshnja, me kapital themeltar 100.000(njeqind mije) leke, me seli rruga "Bardhok Biba" p.75, shk.3 ap.55 Tirane, me kohe zgjatje mbi 10 vjet dhe me objekt te veprimtarise:
- **Prodhime audio-vizive, sherbime dhe asistence teknike ndaj te treteve ne keto fusha.**

Kunder ketij vendimi lejohet ankim.

GJYQETARE

A. Kuoxhiq

Under - registration

1 253/8

2(a) Alternative Sr. P4

(b) Enam R. B. P. 75 Sr. 3
of 55.

(c) In volume 200/1/2/4 or 200/1/2/5
may be taken as per files.

(d) 100 000 New App. 200/1/2/4
then Enam 200/1/2/5.

3. Chamarlate Enam 200/1/2/5.

4. Stateb entu 200/1/2/5
23/2/2001

5. 28/2/2001

Memolet 200/1/2/5
No 10099/36 22/10/2001

G. P. S.
A. K. S.
G. S.

A K T - T H E M E L I M I
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"ARTENATIVA" SH.P.K.



N E N I 1

Erjon Zaloshnja, i biri i Fatmirit dhe i Suzanes, lindur ne Berat me 16.10.1974, banues ne Tirane, Rr. Bardhok Biba, P. 75, Shk. 3, Ap. 55, sot ne date 20.02.2001, themelon shoqerine tregetare me pergjegjesi te kufizuar ARTENATIVA Sh.p.k., ne perputhje me ligjin nr.7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerit Tregetare", si dhe te ligjit Nr.7667 date 28.01.1993 "Per regjistrimin e shoqerive ne regjistrin tregetar".

N E N I 2

Shoqeria vepron ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi si dhe me dispozitat e statutit qe i bashkangjitet ketij akti themeltar.

N E N I 3

Emeri I shoqerise eshte ARTENATIVA sh.p.k.. Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar ARTENATIVA sh.p.k. fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne regjistrin tregetar te Gjykates se Rrethit Tirane.

N E N I 4

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete:
Prodhime audio-vizive, sherbime dhe asistence teknike ndaj te treteve ne keto fusha.

N E N I 5

Selia e shoqerise eshte ne Tirane, Rr. Bardhok Biba, P. 75, Sh. 3, Ap. 55. Aktiviteti i shoqerise mund te shtrihet ne te gjithë territorin e Republikës se Shqiperise. Per kete shoqeria ka te drejte te çele filiale, dege, agjensi apo perfaqesi ne te gjitha qytetet e Republikës se Shqiperise apo jashte saj, ne perputhje me legjislacionin perkates.

N E N I 6

Kapitali themeltar I shoqerise me pergjegjesi te kufizuar ARTENATIVA sh.p.k. eshte 100.000 (Njeqind mije) Leke dhe eshte i ndare ne 100 pjese te barabarta (dividende) nga nje mije leke secila. Shuma e derdhur per formimin e kapitalit themeltar, vertetohet me mandat arketimin leshuar nga banka perkatese.

Erjon Zaloshnja

Kapitali zoterohet ne masen 100% nga ortakut i vetem i shoqerise, Erjon Zaloshnja.

NENI 7

Kapitali themeltar nuk mund te zvogelohet nen ate te parashikuar ne Nenin 6. Me vendim te ortakut te vetem, kapitali themeltar mund te rritet, duke percaktuar edhe numrin e dividendeve qe zoteron ortakut i vetem ose ortaket, ne rast se do te kete te tille ne te ardhmen.

NENI 8

Ortak i vetem i shoqerise eshte Z.Erjon Zaloshnja

NENI 9

Administrator i shoqerise eshte Z.Erjon Zaloshnja.

NENI 10

Kohzgjatja e aktivitetit te shoqerise eshte mbi 10 vjet.

Shoqeria mund te priset para ketij afati, duke zbatuar te gjitha procedurat ligjore te percaktuara per kete qellim dhe pasi te kete shlyer te gjitha detyrimet ndaj te treteve.

NENI 11

Fitimet e shoqerise i perkasin vetem themeluesit te saj.

NENI 12

Shoqeria angazhohet qe ne te gjitha veprimtarine e saj te veproje ne baze te legjislacionit ne fuqi dhe te akteve te themelimit te saj. Ajo angazhohet qe ne veprimtarine e saj te udhheqet nga korrektesia ne marredheni me te tretet dhe shtetin.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

ARTENATIVA sh.p.k.

Erjon Zaloshnja



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE


Nr. 1013 Rep. 79 Kol.

VERTETIM

Ne Tirane, sot ne date 23-02-2001, para meje noteres M. Shorpa, u paraqit personalisht :


Erjon Zaloshnja, i biri i Fatmirit, lindur ne Berat me 16.10.1974, banuese ne Tirane, Rr. Bardhok Biba, P. 75, sh. 3, ap. 55, madhor me zotesi te plote juridike e per te vepruar, identifikuar me pasaporten Nr.0547022, i cili me deklaroi se sa siper eshte akti i themelimit te shoqerise "ARTENATIVA" sh.p.k. e redaktuar me vullnetin e lire e te plote te tij dhe i nenshkruar rregullisht nga ai vete.

One neterja e vertetoj ate sipas ligjes.



NOTERE

Monushope shorpa
et



STATUTI

I

SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"ARTENATIVA" SH.P.K.

I. KRIJIMI, FORMA, EMERTIMI, OBJEKTI, SELIA DHE KOHZGJATJA E SHOQERISE.

NENI 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar ARTENATIVA. sh.p.k., me seli ne Tirane, Rr. Bardhok Biba, P. 75 Shk. 3, Ap.55, eshte krijuar sipas akt themelimit te cilit i bashkangjitet ky statut i perpiluar dhe i nenshkruar nga: **Erjon Zaloshnja**, i biri i Fatmirit dhe Suzanes, lindur ne Berat me 16.10.1974, banues ne Tirane, Rr. Bardhok Biba, P. 75, Shk. 3, Ap. 55, madhor, me zotesi te plote juridike e per te vepruar.

NENI 2

Shoqeria e zhvillon veprimtarine e saj ne Shqiperi ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe normat e ketij statuti. Ajo do t'i nenshtrohet licensimit per aktivitetin qe do te ushtroje nga organet shteterore kompetente. Shoqeria e fiton personalitetin juridik nga dita e regjistrimit te saj ne zyren e regjistrimit tregetar te gjykates se rrethit Tirane. Shoqeria ka vulen e vet me emrin e saj.

NENI 3

Emertimi I shoqerise eshte: **ARTENATIVA sh.p.k.**

NENI 4

Objekti I veprimtarise se shoqerise do te jete:
Prodhime audio-vizive, sherbime dhe asistence teknike ndaj te treteve ne keto fusha.

NENI 5

Selia e shoqerise eshte ne Tirane, Rr. Rr. Bardhok Biba, P. 75, Shk. 3, Ap. 55. Shoqeria mund te hape filiale, dege, agjensi apo perfaqesi ne te gjitha qytetet e vendit apo jashte tij ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi. Gjithashtu ajo mund te shtrije aktivitetin e saj edhe ne vende te tjera ne perputhje me legjislacionin perkates.



NENI 6

Kohezgjatja e shoqerise eshte percaktuar per nje perjudhe kohore mbi 10 vjet, duke filluar nga data e regjistrimit te saj. Ajo mund te shperbehet ne c'do kohe kur e vendos ortakut I vetem, per shkaqe qe i gjen ai te perligjura, apo ne raste te tjera te parashikuara ne ligj.

**II. KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTI,
PJESET E KAPITALIT THEMELTAR.**

NENI 7

Kapitali themeltar I shoqerise eshte 100.000(Njeqind mije)lek, I ndare ne 100 kuota, ku c'do kuote ka vleren e 1000 lekeve.

NENI 8

Kapitali themeltar i shoqerise perbehet nga kontributi i ortakut te vetem. Kapitali themeltar i mesiperm mund te shtohet me vendim te ortakut te vetem. Ai mund te rritet edhe ne natyre.

NENI 9

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ne rruge trashgimie, ne rast ndarje pasurore mes bashkeshorteve dhe ndermjet paraardhesve dhe pasardhesve. Pjeset e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave te trete me miratimin e ortakut te vetem.

Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar duhet te vertetohet me akt noterial.

**III. MARRJA E VENDIMEVE, ADMINISTRIMI KOMPETENCAT
DHE KONTROLLI I SHOQERISE**

NENI 10

Te gjitha vendimet per mbarevajtjen e shoqerise merren nga ortakut I vetem. Vendimet rregjistrohen ne nje liber te vecante qe mbahet ne seline e shoqerise.

Elza Duka

N E N I 11

Shoqeria administrohet nga ortaku I vetem qe do te jete njekohosisht dhe administrator I shoqerise. Administrator I shoqerise do te jete Z. Erjon Zaloshnja. Ai ka gjithashtu te drejte te caktoj nje apo me shume administratores jashte shoqerise .Administratores e jashtem veprojne si ti tille per gjithë kohen e emerimit,por ata mund te shkarkohen edhe me pare nga ortaku I vetem kur veprojne ne kundërshtim me permbushjen e detyres apo te interesave te shoqerise.

N E N I 12

Administratori I shoqerise ka kompetenca per te kryer te gjitha veprimet e administrimit te shoqerise. Ai hyn ne mardhenie me te tretet, lidh kontrata, kryen pagesa dhe c' do veprim tjeter ne emer dhe per llogari te shoqerise. Veprimtaria e kompetencat e tij do te jene ato qe parashikohen edhe nga nenet 15,16,17,18 50 e vijues te ligjit 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare"

Administratores apo administratori pergjigjen per demet qe mund ti shkaktojne shoqerise (me perjashtim te rastit kur shoqeria ka nje ortak te vetem qe eshte njekohosisht dhe administratori i saj).

N E N I 13

Kontrolli i shoqerise kryhet nga nje ekspert kontabel i caktuar nga ortaku i vetem i saj

IV. VITI FINANCIAR DHE LLOGARITE VJETORE.

N E N I 14

C' do vit financiar fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht viti I pare financiar ka filluar ditën e themelimit si person juridik.

N E N I 15

Llogarit vjetore, inventari, raporti mbi veprimtarin e vitit financiar te hartuara nga administratori dhe eksperti kontabel I autorizuar miratohen nga ortaku I vetem. Bilanci vjetor I veprimtarise se shoqerise nxiret brenda 31 marsit te vitit pasardhes.

N E N I 16

Fitimet qe realizohet nga veprimtaria e shoqerise, mbasi zbriten shpenzimet dhe fondi rezerve perdoren nga ortaku I vetem. Ai ka te drejten e perdoromit



MINISTERE
TIRANE

lirisht te fitimeve ne perputhje me qellimin e aktivitetin qe kryen. Vlerat pasurore e materiale te shoqerise kane mbrojtjen e legjislacionit Shqiptar ne fuqi.

V. MARDHENIET E PUNES.

NENI 17

Mardheniet e punes ne shoqeri do te rregullohen sipas legjislacionit Shqiptar te punes dhe atij te sigurimeve shoqerore. Me punonjesit do te lidhen kontrata kolektive dhe individuale. Shoqeria merr persiper te derdhe rregullisht kontributet per sigurimet shoqerore te punonjesve te saj, sipas rregullave te vendosura nga legjislacioni ne fuqi.

NENI 18

Te punesuarit jane te detyruar, te zbatojne c' do akt ligjor e nen ligjor qe lidhet me punen e tyre, normat e ketij statuti dhe kontratat e punes. Per c' do veprim te kondraligjshem te punesuarit pergjigjen vet para ligjit si dhe para shoqerise per demet qe mund ti shkaktojne asaj. C' do mos marveshje qe mund te linde midis te punesuaresve dhe shoqerise do te zgjidhen nga gjykata kompetente.

VI. PRISHJA E SHOQERISE, LIKUJDIMI

NENI 19

Prishja e shoqerise vec rasteve te parashikuara ne ligjin 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerit tregetare" mund te behet ne c' do kohe qe gjykohet nga ortaku I vetem, sic mund te jene rastet e rezultateve me humbje te saj etj. Per kete merret vendim I vecante prej ortakut te vetem. Me marrjen nga ortaku I vetem te vendimit per prishjen e shoqerise, shoqeria hyne ne procesin e likujdimit. Per kryerjen e ketij procesi ortaku I vetem emeron nje ose me shume likujdator te cilet paraqesin raportin dhe bilancin mbi gjendjen e shoqerise. Emertimi I saj ne kete rast do te pasohet nga shenimi "Shoqeri ne likujdim e siper". Pasi behen likujdimet eventuale shoqeria crregjistrohet nga rregjistri tregetar me vendim te gjykates kompetente.

Erabshani e



Per te gjitha mosmarrveshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise dhe qe nuk mund te zgjidhen me mirkuptim organi kompetent per zgjidhjen e tyre eshte gjykata.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

ARTENATIVA sh.p.k.


Erjon Zaloshnja

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr. 1014 Rep. 80 Kol.

VERTETIM

Ne Tirane, sot ne date 23.01.2001, para meje noteres M-sharcka, u paraqit personalisht **Erjon Zaloshnja**, me cilesine e **ortakut te vetem dhe administratorit te shoqerise "ARTENATIVA."** Sh.P.K., i biri i Fatmirit, lindur ne Berat me 16.10.1974, banues ne Tirane, Rr. Bardhok Biba, P. 75, sh. 3, ap. 55, madhor, me zotesi te plote juridike e per te vepruar, identifikuar me pasaporten Nr. 0547022, i cili me deklaroi se sa siper eshte statuti i shoqerise ARTENATIVA sh.p.k. i hartuar me vullnetin e lire e te plote te tij dhe i nenshkruar rregullisht nga ai vete ne pranine time.
Une noterja e vertetoj ate sipas ligjes.

NOTERE



Moushlope sharka
dy

17

2y A Shoshogj
26.02.2001
26 FEB. 2001
NOTI
TIRANE

KERKESE

Per rregjistrimin si person juridik

KERKUESI: Erjon Zaloshnja, i biri Fatmirit, lindur ne Berat me 16.10.1974, banues ne Tirane rruga "Bardhok Biba" Pall.75,Shk.3 Ap.55

25318

OBJEKTI: Kerkohet rregjistrimi si person juridik i Shoqerise "ARTENATIVA" sh.p.k. ne baze te ligjit ligjit 7638 date 19.11.1992 dhe te ligjit 7667 date 28.01.1993



Be refutolet
08/2/2001
[Signature]



Une kerkuesi Erjon Zaloshnja ortak dhe administrator i shoqerise "ARTENATIVA" sh.p.k., kerkoj para kesaj Gjykate regjistrimin e shoqerise "ARTENATIVA" sh.p.k. si person juridik me objekt veprimtarie:

Prodhime audio-vizive, sherbime dhe asistence teknike ndaj te treteve ne keto fusha. Shoqeria "ARTENATIVA" sh.p.k. e ka seline ne Tirane, rruga "Bardhok Biba" pall.75,Shk.3 Ap.55. Kohezgjatja e saj do te jete mbi 10 vjete, me ortak dhe administator kerkuesin Erjon Zaloshnja, me kapital themeltar 100.000 (njqindmije) leke.

Per sa siper, meqe plotesohen kerkesat e ligjit per ushtrimin e aktivitetit te kerkuar, lutem te daktohet nje dite per gjykimin e kesaj kerkese per ligjerimin dhe regjistrimin e shoqerise se mesiperme ne regjistrin tregetar te Gjykates se Rrethit Tirane.

Bashkangjitur kesaj kerkese eshte akti i themelimit te shoqerise, statuti dhe kuitanca bankare per derdhjen e kapitalit themeltar.

KERKUESI
Erjon Zaloshnja

[Signature]


REPUBLIKA E SHQIPERISE
OHOMA E NOTEREVE TIRANE
NR. 4012 REP

VERTETIM

Ne Tirane, sot ne date 23.02.2001, para meje noteres Manushope Shoshogj, u paraqit personalisht:

Erjon Zaloshnja, i biri i Fatmirit, lindur ne Berat me 16.10.1974 banues ne Tirane rruga "B.Biba" Pall.75, shk.3.ap.55, madhor me zotesi te plote juridike e per te vepruar, identifikuar me pasaporten nr.0547022 i cili me deklaroi se sa siper eshte nje kerkese per regjistrimin si person juridik te shoqerise "ARTENATIVA" sh.p.k., e redaktuar me vullnetin e lire e te plote te tij, te cilen e nenshkroi para meje.

Une noterja e vertetoj ate sipas ligjes.



NOTERE

Manushope Shoshogj
[Signature]